

VENDIM
Nr.71, datë 12.12.2007

**PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE NGA
SHOQËRIA “KESH” SHA TE SHOQËRIA “OSSH” SHA**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 20 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.89, datë 13.12.2006, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.a. për transferimin e aseteve te shoqëria “OSSH” sh.a.,

VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për transferimin e aseteve për veprimtarinë e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike nga “KESH” sh.a. te shoqëria “OSSH” sh.a.

- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara, në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta